



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/672

Datë: 09.12.2019

Procesverbal
i mbledhjes së X (dhjetë) për vitin 2019 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -IX- të rregullt dhe mbledhjes së -II- urgjente të KPF-së
2. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë Urbanizëm për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2019.
3. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.
4. Shqyrtimi i kërkesave.
5. Të ndryshme.

Mbledhja u mbajt me datë: 20.11.2019, filloj në ora 14:10, morën pjesë 5 anëtarë të KPF, zyra për informim, përfaqësuesi nga OSBE, si dhe anëtari i Kuvendit Ilaz Krasniqi.

Rahim Morina: Ju përshëndes të gjithëve jemi në mbledhjen e dhjetë rendin e ditës e keni kemi pak material shtesë.

Muharrem Morina: E keni edhe një pikë të kryetarit për shpalljen e një zone me interes të përgjithshëm.

Alban Krasniqi: Kërkesat e Kuvendit duhet të vijnë përmes Kpf dhe duhet t'i kemi të gjitha.

Rahim Morina: Kuvendi i ka organet e veta, unë çdo herë para se me thirr mbledhjen e pyes kryetarin se a ka diçka për mbledhje, ai nganjëherë disa kërkesa po i sjell në kuvend.

Alban Krasniqi: Të hyn raporti i komisionit për ekoregjionin e kemi pas edhe më herët në kuvend, zëvendësimi i një anëtari në Komitetin për Diasporë, si dhe zëvendësimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve.

Rahim Morina: Kush jeni për këtë rend të ditës? Unanimisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së -IX- të rregullt dhe mbledhjes së -II- urgjente të KPF-së

Rahim Morina: Kush jeni për miratim të këtyre procesverbaleve? Unanimisht ishin për miratim.

2. Shqyrtimi i Raportit të Drejtorisë Urbanizëm për realizimin e projekteve kapitale për vitin 2019.

Raimonda Krasniqi: Unë me sa dijë disa projekte as që kanë filluar disa edhe s'kanë përfunduar, por ta rekomandojmë për Kuvend këtë pikë.

Alban Krasniqi: Unë e kam lexuar këtë raport, veç u çudita çka ka të bëjë kur e pash karrige stomatologjike me raport të Urbanizimit, shujtat për nxënës. Duhet me kërkuar një specifikacion për nivelin e realizimit të projekteve për këtë vit.

Rahim Morina: Ne ju kërkojmë një raport shtesë Urbanizmit.

Unanimisht ishin për.

3. Formimi i Komisionit për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2020.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës nr. 01/1359 datë: 05.11.2019 e parashtruar nga Kryetari i Komunës, për shpalljen zonë me interes të përgjithshëm publik të ngastrës kadastrale nr. P-72310047-00501-34, në sipërfaqe prej 2263m², në emër të OPB Mirusha ZK-Malishevë.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend këtë kërkesë? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i kërkesës 01/1358 datë:05.11.2019 për shfuqizimin e vendimit të kuvendit të Komunës së Malishevës nr.02/564 datë: 26.12.2019 i nxjerrë në mbledhjen e mbajtur më datë:21.12.2018.

Muharrem Morina: Kuvendi me këtë vendim e ka tollovitë pak këtë çështje, sepse pala me realizuar atë kërkesë duhet me ba marrëveshje me kryetarin e Komunës, sepse aj vend ka pas specifika tjera dhe aj me mujte me realizuar Ligji kërkon kryetari me ba një vlerësim për çka ju ka dhënë , pastaj padi në Gjykatë me prish marrëveshjen.

Rrahim Morina: Atë vend aty e kanë futë në hipotekë e banka tash ju ka marrë e ja ka shitë diku tjetër.

Hashim Vrenezi: Cili është dallimi i pronave të dhëna për 99 vjet dhe qysh kadastri e ka regjistruar ashtu.

Muharrem Morina: Pronat publike i mbron shteti e pronat shoqërore janë privatizuar, prona publike jepet veç në shfrytëzim.

Alban Krasniqi: E para vendimi a pas marr me nguti, unë jam pas kanë kundër por nëse ska marrëveshje Administratori i Unmik-ut dhe nëse ky dokument s'është si të diskutojmë. Ne duhet këtë vendim me shfuqizuar e pastaj kryetari me formuar një komision për realizimin e asaj kontrate. Para vendimit kryetari a duhet me kerku me ndërpre kontratën se tash është vonë.

Hashim Vrenezi: Le ta kompletton kryetari lëndën e ta bien në kuvend, pëlqimin e PSSP, raport të Komunës për vlerësim të performancës, tatimin në pronë a është paguar për atë vend, cilët hapa ka marrë Komuna në raport me kompaninë, vendimi që ju ka dhënë në hipotekë etj.

6. Shqyrtimi i Draft-Rregullores nr. 04/183 datë: 29.10.2019 mbi pronën e paluajtshme për vitin 2020.

Muharrem Morina: Kjo rregullore është dashtë të miratohet paralelisht me buxhetin.

Hashim Vrenezi: Po këtë rregullore se kanë sjellë me buxhet kur e kemi miratuar.

Alban Krasniqi: Zonat duhet mi rishqyrtuar janë katër zona ka pas zona që para 4 vitesh nuk ka pas ndërtime tani ka, për këto zona duhet me pas edhe harta , pastaj duhet rregullorja me kaluar në debat publik, sa është borxhi në 10 vitet e fundit për mos zbatim të rregullores.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend këtë projekt rregullore? Unanimisht ishin për.

7. Paraqitja e listës së përfituesve me farëra dhe plehra për mbjelljet vjeshtore për vitin 2019.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend? Unanimisht ishin për.

8. Zëvendësimi i një anëtari në Komitetin për Diasporë.

9. Zëvendësimi i një anëtari në Komisionin Komunal të Aksionarëve.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend këtë projekt rregullore? Unanimisht ishin për.

10. Shqyrtimi i Raportit nr. 02/470 datë:19.08.2019 të Komisionit për shqyrtimin e raportit të Kompanisë "Ekoregjioni", Njësia në Malishevë për vitin 2018.

Rrahim Morina: Kush jeni ta rekomandojmë për Kuvend këtë projekt rregullore? Unanimisht ishin për.

11. Shqyrtimi i kërkesave për ndërrim destinime:

Kërkesa nr.06/83 datë:06.11.2019 e parashtruar nga z.Bajram Fetah Mazreku nga Malisheva, për ndërrim të destinimit prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/91 datë:18.11.2019 e parashtruar nga Afrim Mazreku nga Malisheva, për ndërrim të destinimit prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/93 datë:18.11.2019 e parashtruar nga Bujar Morina (Gllareva Sh.p.k) nga Gllareva, për ndërrim të destinimit prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/94 datë:14.11.2019 e parashtruar nga Hafir Mazreku nga Malisheva, për ndërrim të destinimit prej tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Muharrem Morina: Aty ku plani zhvillimor i Komunës parasheh zona ndërtimore se di pse po ju lodhin juve drejtoritë me këto kërkesa në Kuvend.

Rahim Morina: Ja kthejmë këto kërkesa drejtorisë për Urbanizëm aty ku parashihen ndërtimet me Pzhk, le t'i zhvillon vet drejtoria procedurat. Unanimisht ishin që kërkesat ti kthehen Drejtorisë për Urbanizëm.

12. Shqyrtimi i kërkesave.

Kërkesa nr.02/615 datë: 14.11.2019 e parashtruar nga z. Bajram Berisha nga fshati Lladroviq

Kërkesa nr.02/624 datë:19.11.2019 e parashtruar nga Shoqata e Invalidëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-Dega në Malishevë, për ndarjen e mjeteve financiare për shërim për z.Arsim Paçarizi nga fshati Dragobil

Rahim Morina: Pas propozimeve që këto këtyre parashtruesve të kërkesave tju ndajmë nga 950, kush jeni për miratim? Unanimisht ishin për miratim që këto dy kërkesa të miratohen me nga 950 euro.

Valon Krasniqi: Një vendim për parking që është pas miratuar nga Kuvendi spo zbatohet dhe Policia po ju shqipton gjoka qytetarëve. Ka qenë mirë të njoftohen Policia se ka një vendim të Kuvendit për atë pjesë për parking.

Alban Krasniqi: Kryesuesi ju bën një shkresë Policisë dhe i njofton se ka një vendim të kuvendit dhe ata duhet ta zbatojnë atë vendim.

Ilaz Krasniqi: Njëjtë ka qenë edhe për heqjen e reklamave, disa vendime të kuvendit nuk po zbatohen.

Alban Krasniqi: Vendimi është i plotfuqishëm por tabelat e vendosura nuk janë në rregull. Kryesues në e kemi buxhetin për rregullimin e sallës së kuvendit që dy vite e kam ngrite këtë çështje sa i përket foltores, janë disa karrige të prishta, ska nxemje si duhet është mirë me drejtorinë e financave me bë një zgjidhje.

Zyra për informim kur bënë një draft për publikim pas përfundimit të mbledhjeve duhet me dergu te kryesuesi me pa njëherë shkrimin, sepse janë medium publik e jo i pavarur. Çështja e kallëzimit penal që ka qenë edhe përmes mjeteve të informimit Komiteti për Politikë dhe Financa e mirëpresim filluar hetimet ndaj kryetarit dhe të tjerëve.


Rahim Morina:

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 15.30 minuta.

Procesmbajtësi

Naim Avdijaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Rahim Morina

